

Universiteti Politeknik i Tiranës, Instituti i Gjeoshkencave, Energjisë, Ujit dhe Mjedisit shpall vendet e punës për 2 (dy) personel ndihmësakademik (specialist) me kohë të plotë pranë Departamentit të Sizmologjisë, si më poshtë:

1 (një) personel ndihmësakademik (specialist) profili “Telekomunikacion”.

1. Të ketë Diplomë Universitare të ciklit të dytë “Master i Shkencave”, në Telekomunikacion.
2. Përbën avantazh, të ketë eksperiencë pune, së paku 5 vjet, në fushën përkatëse.
3. Njohuri të mira të gjuhës angleze, të dokumentuar me dëshminë përkatëse.
4. Të njohë mirë sistemet e shfrytëzimit MS Windows dhe Linux etj.
5. Të ketë njohuri ne programim.
6. Të zotërojë leje drejtimi automjeti.
7. Preferohen kandidatët me mesatare të studimeve universitare sa më të lartë.
8. Aftësi të mira të punës në grup.
9. Të jetë i disponueshëm dhe të punojë në mënyrë të pavarur në terren për riparimin e paisjeve në stacionet sizmologjike dhe në qendrën kombëtare të monitorimit, për kontrollin, mirëmbajtjen dhe konfigurimin e paisjeve të rrjetit sizmologjik, përfshirë këtu edhe rastin e situatave emergjente sizmike.

1 (një) personel ndihmësakademik (specialist) profili “Inxhinieri Fizike”.

1. Të ketë Diplomë Universitare të ciklit të dytë “Master i Shkencave”, në Inxhinieri Fizike.
2. Përbën avantazh, të ketë eksperiencë pune, së paku 5 vjet, në fushën përkatëse.
3. Njohuri të mira të gjuhës angleze, të dokumentuar me dëshminë përkatëse.
4. Të njohë mirë sistemet e shfrytëzimit MS Windows dhe Linux etj.
5. Të ketë njohuri ne programim.
6. Të zotërojë leje drejtimi automjeti.
7. Preferohen kandidatët me mesatare të studimeve universitare sa më të lartë.
8. Aftësi të mira të punës në grup.
9. Të jetë i disponueshëm dhe të punojë në mënyrë të pavarur në terren për riparimin e paisjeve në stacionet sizmologjike dhe në qendrën kombëtare të monitorimit, për kontrollin, mirëmbajtjen dhe konfigurimin e paisjeve të rrjetit sizmologjik, përfshirë këtu edhe rastin e situatave emergjente sizmike.

DOKUMENTACIONI DHE AFATI I DORËZIMIT

Të gjithë kandidatët që aplikojnë duhet të paraqesin brenda datës **09.01.2021** pranë Zyrës së Burimeve Njerëzore në Rektoratin e Universitetit Politeknik të Tiranës dokumentacionin e mëposhtëm:

1. Letër motivimi;
2. Jetëshkrimin (CV) sipas formatit standard;
3. Fotokopje të pasaportës ose kartës së identitetit;

4. Diplomën e studimeve universitare dhe listën e notave të noterizuara; (Aplikantët që kanë kryer studime jashtë shtetit duhet të kenë bërë njohjen e diplomave nga MASR);
5. Kopje e Diplomës Master i Nivelit të Dytë ose "DOKTOR" të noterizuar, në rast se ka. (Aplikantët që kanë kryer studime jashtë shtetit duhet të kenë bërë njohjen e diplomave nga MASR);
6. Fotokopje të librezës së punës të noterizuar;
7. Vetëdeklarimin e gjendjes gjyqësore;
8. Vërtetim të gjendjes shëndetësore;
9. Çdo dokumentacion tjetër që vërteton trajnimet, kualifikimet, arsimin shtesë, vlerësimet pozitive apo të tjera të përmendura në jetëshkrimin e paraqitur;
10. Dëshminë e gjuhës së huaj të noterizuar.